

**KOMBET E  
BASHKUARA**

---



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen  
Penale të Personave Përgjegjës për  
Shkelje të Rënda të së Drejtës  
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera  
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej  
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84-R77.1-  
ES

Data: 28 shtator 2011

Origjinali: anglisht

---

**KRYETARI I TRIBUNALIT NDËRKOMBËTAR**

**Para:** Gjykatësit Patrick Robinson, Kryetar

**Sekretari:** Z. John Hocking

**Vendim:** 28 shtator 2011

**PROKURORI**

**k.**

**SHEFQET KABASHIT**

***PUBLIK***

---

**VENDIM I KRYETARIT LIDHUR ME LIRIMIN E PARAKOHSHËM TË  
SHEFQET KABASHIT**

---

**Zyrës së Prokurorit:**

Z. Joanna Korner

**Avokatit të Shefqet Kabashit:**

Z. Michael G. Karnavas

1. Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (“Tribunali”) ka marrë kërkesën e z. Shefqet Kabashi për lirim të parakohshëm (“Kërkesë”).<sup>1</sup>

#### A. Përshkrim i Rrethanave

2. Më 20 shtator 2011, avokati i Z. Kabashi paraqiti një kërkesë për lirim të parakohshëm duke u bazuar në Nenin 28 të Statutit të Tribunalit (“Statuti”), Rregullat 124 dhe 125 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit (“Rregullorja”) dhe paragrafin 2 të Udhëzimit Praktik mbi Procedurën e Vendimeve mbi Kërkesat për Falje, Ulje të Dënimit dhe Lirim të Parakohshëm të Personave të Dënuar nga Tribunali Ndërkombëtar (“Udhëzim Praktik”).<sup>2</sup> Z. Kabashi kërkon shqyrtim urgjent të kërkesës së tij në mënyrë që në rast se miratohet, ai të lirohet më 25 shtator 2011 pasi ka kryer dy të tretat e dënimit.<sup>3</sup>

3. Më 21 shtator 2011, Prokuroria dorëzoi “Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës Urgjente të Shefqet Kabashit për Lirim të Parakohshëm” (“Përgjigje”), ku bën të ditur se mban qëndrim neutral në lidhje me kërkesën e z. Kabashi për lirim të parakohshëm dhe rrjedhimisht nuk bën asnjë parashtrim.<sup>4</sup>

#### B. Procedimi në Tribunal

4. Më 5 qershor 2007, z. Shefqet Kabashi u paraqit para Dhomës Gjyqësore I (“Dhoma Gjyqësore”) si dëshmitar i Prokurorisë në çështjen *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T (procesi *Haradinajt dhe të tjerë*). Pasi u paraqit në bankën e të akuzuarit, z. Kabashi refuzoi të dëshmonte.<sup>5</sup> Dhoma Gjyqësore vendosi ta procedonte penalisht z. Kabashi për shpërfillje të Tribunalit dhe i kërkoi të paraqitej më 7 qershor 2007.<sup>6</sup>

<sup>1</sup> *Prokurori k. Shefqet Kabashit*, Lënda Nr. IT-04-84-R.77.1-ES, Kërkesë Urgjente e Shefqet Kabashit për Lirim të Parakohshëm (Publike me Shtojcën Konfidenciale D), 20 shtator 2011 (“Kërkesë”).

<sup>2</sup> IT/146Rev.3, 16 shtator 2010.

<sup>3</sup> Kërkesë, f 5.

<sup>4</sup> *Prokurori k. Shefqet Kabashit*, Lënda Nr. IT-04-84-R.77.1-ES, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës Urgjente të Shefqet Kabashit për Lirim të Parakohshëm, 21 shtator 2011 (“Përgjigje”), f 2.

<sup>5</sup> *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, 5 qershor 2007, T. 5441-5443, 5445-5448.

<sup>6</sup> *Në Çështjen e Shpërfilljes së Tribunalit nga Shefqet Kabashi*, Lënda Nr. IT-04-84-R.77.1, Urdhër në Vend të Aktakuzës lidhur me Çështjen e Shpërfilljes së Tribunalit nga Shefqet Kabashi, 5 qershor 2007.

Z. Kabashi nuk u paraqit para Dhomës Gjyqësore më 7 qershor 2007 dhe po atë ditë Dhoma Gjyqësore lëshoi një fletarrestim për z. Kabashi.<sup>7</sup>

5. Më 20 nëntor 2007, z. Kabashi u paraqit për herë të dytë para Dhomës Gjyqësore për të dëshmuar nëpërmjet videokonferencës, mirëpo ai nuk pranoi të dëshmonte dhe nuk iu përgjigj pyetjeve që iu bënë.<sup>8</sup>

6. Më 11 dhjetor 2007, Dhoma Gjyqësore ia kaloi çështjen e shpërfilljes Prokurorisë për hetim dhe procedim të mëtejshëm penal.<sup>9</sup> Më 13 dhjetor 2007, Prokuroria parashtroi një kërkesë për leje për ndryshimin e Urdhrit në vend të Aktakuzës,<sup>10</sup> të cilën Dhoma Gjyqësore e miratoi.<sup>11</sup> Aktakuza e ndryshuar e akuzoi z. Kabashi me dy pika për shpërfillje të Tribunalit, për refuzimin ose mospranimin e vazhdueshëm të tij për të dëshmuar, më 5 qershor 2007 dhe 20 nëntor 2007.<sup>12</sup>

7. Më 17 gusht 2011, z. Kabashi u arrestua në Holandë. Më 18 gusht 2011 ai u transferua në Qendrën e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara (“QPKB”).

8. Më 31 gusht 2011, Z. Kabashi u vetëdeklarua fajtor në lidhje me dy pika të shpërfilljes së Tribunalit, për mosbindjen apo mospranimin e tij për t’iu përgjigjur pyetjeve të Prokurorisë më 5 qershor 2007 dhe 20 nëntor 2007. Dhoma për çështjen e shpërfilljes së Tribunalit<sup>13</sup> e pranoi deklarin e fajësisë prej tij.<sup>14</sup>

---

<sup>7</sup> Në Çështjen e Shpërfilljes së Tribunalit nga. *Shefqet Kabashi*, Lënda Nr. IT-04-84-R.77.1, Fletarrestim dhe Urdhër për Dorëzimin e Shefqet Kabashit, 7 qershor 2007.

<sup>8</sup> *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, 20 nëntor 2007, T. 10935-10941.

<sup>9</sup> Në Çështjen e Shpërfilljes së Tribunalit nga. *Shefqet Kabashi*, Lënda Nr. IT-04-84-R.77.1, Vendim konfidencial dhe *ex parte* për Kthimin e Çështjes Prokurorisë, 11 dhjetor 2007, para 7.

<sup>10</sup> *Prokurori k. Shefqet Kabashit*, Lënda Nr. IT-04-84-R.77.1, Parashtrim konfidencial dhe *ex parte* i Prokurorisë mbi një Aktakuzë Kundër Shefqet Kabashit, 13 dhjetor 2007; *shih* edhe *Prokurori k. Shefqet Kabashit*, Lënda Nr. IT-04-84-R.77.1, Shtojcë konfidenciale dhe *ex parte* e Prokurorisë e Mocionit të 13 dhjetorit 2007 Lidhur me Aktakuzën Kundër Shefqet Kabashit, 19 dhjetor 2007.

<sup>11</sup> *Prokurori k. Shefqet Kabashit*, Lënda Nr. IT-04-84-R.77.1, Vendim për Lejimin e Ndryshimit të Aktakuzës, 18 shkurt 2008.

<sup>12</sup> *Prokurori k. Shefqet Kabashit*, Lënda Nr. IT-04-84-R.77.1, Aktakuzë e Ndryshuar, 18 shkurt 2008.

<sup>13</sup> Dhoma Gjyqësore në çështjen e shpërfilljes së Tribunalit pas arrestimit të z. Kabashi përbëhej nga gjykatësi Alphons Orië (kryegjykatës), gjykatësi O-Gon Kwon dhe gjykatësi Howard Morrison (“Dhoma për Shpërfilljen e Tribunalit”); *Prokurori k. Shefqet Kabashit*, Lënda Nr. IT-04-84-R.77.1, Urdhër për Zëvendësimin e një Gjykatësi në Një Çështje para një Dhome Gjyqësore, 29 gusht 2011.

<sup>14</sup> *Prokurori k. Shefqet Kabashit*, Lënda Nr. IT-04-84-R.77.1, Seanca mbi Dënimin, 31 gusht 2011, T. 86-88.

9. Më 16 shtator 2011, z. Kabashi u dënua me dy muaj burgim, duke iu llogaritur edhe periudha e kaluar në paraburgim prej 31 ditësh.<sup>15</sup>

### C. Ligji Përkatës

10. Në bazë të Nenit 28 të Statutit, në qoftë se në bazë të ligjit në fuqi në shtetin ku i dënuari kryen burgimin, ai ose ajo plotëson kushtet për t'u konsideruar për falje ose ndryshimin e dënimit, shteti përkatës njofton Tribunalin dhe Kryetari, në konsultim me gjykatësit, vendos për çështjen në bazë të interesave të drejtësisë dhe të parimeve të përgjithshme të së drejtës. Rregulla 123 e Rregullores i bën jehonë Nenit 28 të Statutit dhe Rregulla 124 e Rregullores përcakton se pas këtij njoftimi, Kryetari, në këshillim me anëtarët e Byrosë dhe cilindo gjykatës të përhershëm të Dhomës që dha dënimin, që është ende gjykatës i Tribunalit, vendos mbi përshtatshmërinë e faljes ose uljes së dënimit. Në Rregullën 125 të Rregullores përcaktohet se në përcaktimin e përshtatshmërisë së faljes ose uljes së dënimit, Kryetari merr parasysh, ndër të tjera, peshën e krimit apo të krimeve për të cilat është dënuar i burgosuri, trajtimin e të burgosurve në rrethana të ngjashme, prova të rehabilitimit nga ana e të burgosurit, si dhe çfarëdo bashkëpunimi thelbësor të të burgosurit me Prokurorinë.

11. Në Rregullën 102 (A), “Statusi i Personit të Shpallur Fajtor”, shkruhet si vijon:

Dënimi llogaritet prej ditës së shpalljes së tij. Mirëpo, menjëherë pas dhënies së njoftimit për apel, zbatimi i aktgjykimit pezullohet deri në shpalljen e vendimit të apelit, teksa personi i shpallur fajtor vazhdon të mbahet në paraburgim, sipas Rregullës 64.

Rrjedhimisht gjatë kohës që pritet vendimi mbi apelin dhe personi i shpallur fajtor ende mbahet i paraburgosur në QPKB, Dhoma e Apelit e caktuar për këtë çështje ka vetëm mundësinë procedurale të lirimit të përkohshëm, në përgjigje të një kërkesë për lirim nga paraburgimi.<sup>16</sup> Mirëpo në rrethanat kur nuk janë paraqitur apele dhe personi i shpallur fajtor

<sup>15</sup> *Prokurori k. Shefqet Kabashit*, Lënda Nr. IT-04-84-R.77.1, Aktgjykimi i Dënimit, 16 shtator 2011, (“Aktgjykimi i Dënimit”), para 18-19.

<sup>16</sup> *Prokurori k. Millan Gveros*, Lënda Nr. IT-05-88-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e parakohshëm të Millan Gveros, 28 qershor 2010, para 7; *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-A, Vendim mbi Kërkesën e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 25 maj 2009; *Prokurori k. Mile Mërkshiqit dhe Veselin Shlivançaninit*, Lënda Nr. IT-95-13/1-A, Vendim mbi Mocionin e Veselin Shlivançaninit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 11 dhjetor 2007, f 3; *Prokurori k. Veselin Shlivançaninit*, Lënda Nr. IT-95-13/1-T, Vendim konfidencial dhe *ex parte* mbi Kërkesën për Lirim të Parakohshëm ose Ndryshe mbi Mocionin për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 9 nëntor 2007; *Prokurori k. Enver Haxhihasanoviqit dhe Amir Kuburës*, Lënda Nr. IT-01-47-A, Vendim mbi Mocionin në Emër të Enver Haxhihasanoviqit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 20 qershor 2007, para 15; *Prokurori k. Enver Haxhihasanoviqit dhe Amir Kuburës*, Lënda Nr. IT-01-47-A, Vendim i Kryetarit mbi Kërkesën e Enver

ende mbahet i paraburgosur në QPKB, kërkesën për lirim e shqyrton Kryetari i Tribunalit.<sup>17</sup> Në kushte të tilla, megjithëse Statuti, Rregullorja dhe Udhëzimi Praktik nuk e trajtojnë rastin kur personi i shpallur fajtor mbahet në QPKB dhe jo në një nga shtetet përmbarese të dënimit, “kushtet për të drejtën e marrjes në konsideratë për falje ose ulje të dënimit duhet të vlejnjë njëlloj për të gjithë individët e shpallur fajtorë dhe dënuar nga Tribunali” dhe “e drejta për t’u konsideruar e individëve të cilët e kryejnë dënimin në QPKB, duhet përcaktuar duke marrë parasysh kushtet e ngjashme nga shtetet përmbarese të dënimit”.<sup>18</sup>

#### D. Diskutim

12. Në marrjen e vendimit nëse miratimi i lirimimit të parakohshëm është i përshtatshëm, jam konsultuar me gjykatësit e Byrosë dhe gjykatësit e përhershëm të Dhomës që dha dënimin, të cilët janë ende gjykatës të Tribunalit.

##### 1. Trajtimi i Të Burgosurve në Rrethana të Ngjashme

13. Që prej 25 shtatorit 2011, Z. Kabashi ka kaluar 40 ditë i paraburgosur nga Tribunali, periudhë që mbulon dy të tretat e kohëzgjatjes së dënimit të dhënë nga Dhoma në çështjen e shpërfilljes së Tribunalit. Në praktikën e Tribunalit, personat e dënuar konsiderohen për lirim të parakohshëm, pasi të kenë kryer së paku dy të tretat e dënimit.<sup>19</sup> Theksoj se një i dënuar i

---

Haxhihasanoviçit për Lirim të Parakohshëm, 12 prill 2007, para 14; *Prokurori k. Kvoçkës dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-98-30/1-A, Vendim mbi Kërkesën e Miroslav Kvoçkës për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 17 dhjetor 2003, f. 3; *Prokurori k. Dario Kordiçit dhe Mario Çerkezit*, Lënda Nr. IT-95-14/2-A, Vendim mbi Kërkesën e Mario Çerkezit Kvoçkës për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 12 dhjetor 2003; *Prokurori k. Kvoçkës dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-98-30/1-A, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të Miroslav Kvoçkës, 13 dhjetor 2002.

<sup>17</sup> *Prokurori k. Millan Gveros*, Lënda Nr. IT-05-88-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të Millan Gveros, 28 qershor 2010, para 7; *Prokurori k. Veselin Shlivançaninit*, Lënda Nr. IT-95-13/1-T, Vendim konfidencial dhe *ex parte* mbi Kërkesën për Lirim të Parakohshëm ose Ndryshe mbi Mocionin për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 9 nëntor 2007; *Prokurori k. Enver Haxhihasanoviçit dhe Amir Kuburës*, Lënda Nr. IT-01-47-A, Vendim i Kryetarit mbi Kërkesën e Enver Haxhihasanoviçit për Lirim të Parakohshëm, 12 prill 2007; *Prokurori k. Enver Haxhihasanoviçit dhe Amir Kuburës*, Lënda Nr. IT-01-47-A, Vendim i Kryetarit mbi Kërkesën e Amir Kuburës për Lirim të Parakohshëm, 11 prill 2006.

<sup>18</sup> *Prokurori k. Millan Gveros*, Lënda Nr. IT-05-88-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të Millan Gveros, 28 qershor 2010, para 7; *Prokurori k. Miroslav Kvoçkës*, Lënda Nr. IT-98-30/1-A, Vendim mbi Kërkesën për Falje ose Ulje të Dënimit, 30 mars 2005, para 4; *Prokurori k. Millorad Kërnojelacit*, Lënda Nr. IT-97-25-ES, Vendim konfidencial i Kryetarit mbi Kërkesën për Falje ose Ulje të Dënimit të Millorad Kërnojelacit, 21 qershor 2005, para 5.

<sup>19</sup> *Prokurori k. Dragan Obrenoviçit*, Lënda Nr. IT-02-60/2-ES, Vendim konfidencial i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të Dragan Obrenoviçit, 21 shtator 2011, para 16; *Prokurori k. Ivica Rajiqit*, Lënda Nr. IT-05-12-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të Ivica Rajiqit, 22 gusht 2011, para 12; *Prokurori k. Millomir Stakiçit*, Lënda Nr. IT-97-24-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të Millomir Stakiçit, 15 korrik 2011, para 22; *Prokurori k. Momçillo Krajishnikut*, Lënda Nr. IT-00-39-ES, Vendim i Kryetarit mbi

cili ka kryer dy të tretat e dënimit ka thjesht të drejtë të konsiderohet për lirim të parakohshëm, por jo të drejtë për t'u liruar para kohe. Duke marrë parasysh trajtimin e personave në rrethana të ngjashme, kam mendimin se periudha e dënimit të kryer nga z. Kabashi anon në dobi të lirit të tij të parakohshëm.

## 2. Pesha e Krimeve

14. Në lidhje me peshën e krimeve për të cilat u dënua z. Kabashi, Dhoma në çështjen e shpërfilljes së Tribunalit i ka cilësuar këto krime si dy raste të refuzimit ose mospranimit kokëfortë për t'iu përgjigjur pyetjeve në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*. faktor që e privoi Dhomën Gjyqësore “prej dëshmimeve të nevojshme për zbulimin e suksesshëm të së vërtetës në gjykimin e kësaj çështjeje”.<sup>20</sup>

15. Gjykoj se krimet e z. Kabashi janë serioze sepse ato kërcënojnë efikasitetin e funksionimit të Tribunalit. Rrjedhimisht mendoj se pesha e krimeve të z. Kabashi është faktor kundër lirit të tij të parakohshëm.

---

Lirimin e Parakohshëm të Momçillo Krajishnikut, 11 korrik 2011, para 21; *Prokurori k. Veselin Shlivançaninit*, Lënda Nr. IT-95-13-ES.1, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të Veselin Shlivançaninit, 5 korrik 2011, para 20; *Prokurori k. Johan Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të Johan Tarçulovskit, 23 qershor 2011, para 13; *Prokurori k. Bllagoje Simiqit*, Lënda Nr. IT-95-9-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të Bllagoje Simiqit, 15 shkurt 2011, para 20; *Prokurori k. Darko Mërgjës*, Lënda Nr. IT-02-59-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të Darko Mërgjës, 1 shkurt 2011, para 15; *Prokurori k. vica Rajiqit*, Lënda Nr. IT-95-12-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të Ivica Rajiqit, 31 janar 2011, para 14; *Prokurori k. Zoran Zhigiqit*, Lënda Nr. IT-98-30/1-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të Zoran Zhigiqit, 8 nëntor 2010, para 12; *Prokurori k. Haradin Balës*, Lënda Nr. IT-05-66-ES, Vendim mbi Kërkesën e Haradin Balës për Ulje të Dënimit, 15 tetor 2010, para 14; *Prokurori k. Momçillo Krajishnikut*, Lënda Nr. IT-00-39-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të Momçillo Krajishnikut, 26 korrik 2010, para 14; *Prokurori k. Millan Gveros*, Lënda Nr. IT-05-88-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të Millan Gveros, 28 qershor 2010, para 8; *Prokurori k. Darko Sikiricës*, Lënda Nr. IT-05-8-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të darko Sikiricës, 21 qershor 2010, para 13; *Prokurori k. Dragan Zelenoviqit*, Lënda Nr. IT-96-23/2-ES, Vendim i Kryetarit mbi Kërkesën për Falje ose Ulje të Dënimit të Dragan Zelenoviqit, 10 qershor 2010, para 13; *Prokurori k. Dario Kordiqit*, Lënda Nr. IT-95-14/2-ES, Vendim i Kryetarit mbi Kërkesën për Falje ose Ulje të Dënimit të Dario Kordiqit, 13 maj 2010, para 13; *Prokurori k. Mllado Radiqit*, Lënda Nr. IT-98-30/1-ES, Vendim i Kryetarit mbi Kërkesën për Falje ose Ulje të Dënimit të Mllado Radiqit, 23 prill 2010, para 12-13; *Prokurori k. Mitar Vasilevqiqit*, Lënda Nr. IT-98-32-ES, Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Kryetarit mbi Kërkesën për Falje ose Ulje të Dënimit të Mitar Vasilevqiqit, 12 mars 2010, para 14; *Prokurori k. Dragan Jokiqit*, Lënda Nr. IT-02-60-ES & IT-05-88-R77.1-ES, Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Kryetarit mbi Kërkesën për Falje ose Ulje të Dënimit të Dragan Jokiqit i 8 dhjetorit 2009, 13 janar 2010, para 14; *Prokurori k. Bilana Pllavshiqit*, Lënda Nr. IT-00-39 & 40/1-ES, Vendim i Kryetarit mbi Kërkesën për Falje ose Ulje të Dënimit të Zj. Bilana Pllavshiq, 14 shtator 2009, para 10.

<sup>20</sup> Aktgjykimi i Dënimit, para 13.

### 3. Prova e Rehabilitimit

16. Rregulla 125 e Rregullores përcakton se Kryetari merr parasysh prova të rehabilitimit të të burgosurit. Paragrafi 3(h) i Udhëzimit Praktik përcakton se Sekretaria kërkon raporte dhe komente prej autoriteteve përkatëse në shtetin përmbarues të dënimit për sjelljen e të dënuarit gjatë periudhës së burgimit. Duke marrë natyrën urgjente të kërkesës së z. Kabashi për lirim të parakohshëm, unë nuk disponoj raporte apo komente nga QPKB-ja në lidhje me sjelljen e z. Kabashi në paraburgim. Gjykoj se mungesa e këtyre raporteve është faktor neutral që nuk anon as në dobi dhe as kundër lirim të parakohshëm të z. Kabashi.

17. Paragrafi 3(b) i Udhëzimit Praktik parashikon raporte mbi gjendjen psikike të të dënuarit gjatë burgimit të tij ose të saj. Z. Kabashi ka paraqitur një raport mjekësor nga mjeku i QPKB-së ku lexohet se pas një vlerësimi psikiatrik, u konkludua se z. Kabashi vuan nga çrregullimi i stresit pastraumatik (“ÇSPT”).<sup>21</sup> Raporti nuk tregon se ÇSPT-ja e z. Kabashi do ta bënte atë të rrezikshëm për të tjerët.<sup>22</sup> Rrjedhimisht konkluzioni im është se Çrregullimi i Stresit Pastraumatik është faktor neutral në përcaktimin e provës së rehabilitimit.

18. Bazuar në sa më sipër, gjykoj se mungesa e provës së rehabilitimit është faktor neutral i cili nuk anon as në dobi, as kundër kërkesës së tij për lirim të parakohshëm.

### 4. Bashkëpunimi thelbësor me Prokurorinë

19. Në Rregullën 125 të Rregullores përcaktohet se Kryetari merr parasysh çfarëdo bashkëpunimi thelbësor të të burgosurit me Prokurorinë. Në Përgjigje, Prokuroria shprehet se nuk synon të bëjë parashtrime lidhur me kërkesën e z. Kabashi për lirim të parakohshëm, duke adoptuar qëndrim neutral ndaj Kërkesës.<sup>23</sup> Rrjedhimisht unë gjykoj se faktori i bashkëpunimit thelbësor me Prokurorinë është neutral në lidhje me kërkesën e z. Kabashi për lirim të parakohshëm.

---

<sup>21</sup> Kërkesë, Shtojca C.

<sup>22</sup> Kërkesë, Shtojca C.

<sup>23</sup> Përgjigje, f 2.

5. Konkluzion

20. Duke marrë parasysh gjithë sa më sipër dhe pas analizimit të faktorëve të identifikuar të Rregullës 125 të Rregullores, gjykoj se pavarësisht se Z. Kabashi plotëson kushtet për t'u konsideruar për lirim të parakohshëm për arsye të kryerjes së dy të tretave të dënimit, pesha e krimeve të tij përlligj rrëzimin e kërkesës.

21. Theksoj se dy nga kolegët e mi kanë mendimin se z. Kabashi duhet liruar dhe dy kanë pikëpamjen e kundërt.

E. Vendim

22. Për arsyet e lartpërmendura dhe bazuar në Nenin 28 të Statutit, Rregullat 124 dhe 125 të Rregullores dhe paragrafin 8 të Udhëzimit Praktik, RRËZOHET kërkesa e z. Shefqet Kabashi për lirim të parakohshëm.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/  
Gjykatës Bakone Justice Moloto  
Kryegjykatës

Sot, më 28 shtator 2011.  
Në Hagë  
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]